

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Pune

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Ndërtimi i linjës 110 kV Zogu i Zi – Tirana Qendër dhe punime në N/Stacionin Tirana Qendër”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

31321000-2 - Linja të energjisë elektrike.

VLERA E FONDIT LIMIT:

287,336,864 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **“Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 285,000,000 (dyqind e tetëdhjetë e pesë milion) Lekë.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë vertetim nga Administrata Tatimore ku të tregohet xhiroja vjetore për vitet e sipërpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine e mallrave dhe punimet objekt procedure prokurimi, kërkohej që OE ofertues të paraqeste se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros duhet të jete në masën 285,000,000 (dyqind e tetëdhjetë e pesë milion) Leke.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues për të provuar përvojën e mëparshme, duhet të ketë realizuar të paktën:*

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 140,000,000 (njëqind e dyzet milion) lekë pa TVSH dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më të vogël se 550,000,000 (pesëqind e pesëdhjetë milion) lekë pa TVSH.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE Ofertues duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, OE Ofertues duhet të paraqesë si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Shenim: Kontrata të ngjashme persa i perket punimeve elektrike për vete specifiken që kanë, do të konsiderohen punimet në Linjat elektrike dhe Nënstacionet elektrike me nivel tensioni ≥ 110 kV.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, si dhe punimet e kërkuara, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë sipas parashikimeve ligjore. Në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Gjithashtu, duke patur në vëmendje punën e vështirë dhe llojin e vecantë që duhet të bëjë OE në realizimin e kësaj kontrate, AK kërkon me doemos që OE ofertues t’i ketë një përvojë të ngjashme të kësaj natyre.

Përsa i përket cilësimit të kontratave të ngjashme, sipas opinionit teknik të inxhinierëve të AK gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit, sqarojmë se Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. administron rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike me tension 110-400 kV, që përbëhet nga nënstationet 400/220 kV, nënstatione 110/TM kV dhe linjat 110/220/400 kV.

Për të garantuar funksionimin normal dhe të sigurtë të sistemit elektro-energjetik, OST sh.a. ka për detyrë zhvillimin, automatizimin, rehabilitimin, mirëmbajtjen e komponentëve të Sistemit të Transmetimit.

Theksojmë se, OST sh.a. është institucioni i vetëm menaxhues i objekteve me këto nivele tensioni.

Garantimi i qëndrueshmërisë të Sistemit Energjitik si dhe siguria e furnizimit me energji elektrike në tensionet e larta bazohet në zbatimin e rreptë të rregulloreve të Sigurimit Teknik dhe të Shfrytëzimit Teknik të Nënstacioneve dhe Linjave të Sistemit Energjitik.

Për të bërë një krahasim të nivelit teknik/profesional të kërkuar në punimet në pajisjet e tensionit të lartë argumentojmë si vijon për punimet me nivel tension 110, 220 dhe 400 kV:

- Rrjetet 110, 220 dhe 400 kV, administruar nga OST sh.a. janë të ndërtuar në ajër (AIS) pra, përdorin qëndrueshmërinë elektrike të ajrit si material izolues. Ato kërkojnë sipërfaqe të madhe dhe në shumë raste punime në hapësira që janë afër pajisjeve nën tension të lartë që paraqesin rrezikshmëri të lartë për operatorët. Puna e tyre mbikëqyret dhe kushtëzohet nga kërkesat e rregulloreve të sipërpërmendura. Në nënstacion/linja mund të punojnë vetëm operatorë të instruktuar dhe me kartelë të sigurimit teknik.
 - Pajisjet primare vendosen në bazamente betoni të armuar dhe konstruksione mekanike të veçanta. Theksojmë që pajisjet primare janë të rënda dhe njëkohësisht tepër delikate. Ato kërkojnë makina ngritese/transportuese si dhe rrespektimin e rregullave të veçanta për transportin, lëvizjen, vendosjen në bazament dhe montimin.
 - Punimet për kabllimin, testimin, komisionimin e tyre, të cilat kryhen për secilin element kanë nevojë për operatorë shumë të specializuar për shkak të vështirësive, kompleksitetit të punimeve dhe kanë një kosto relativisht të madhe.
 - Mbrojtja rele është një pajisje komplekse që shfrytëzon të dhëna të kombinuara (rryme/tension) dhe mbrojtje rryme, të cilat kabllohen duke krijuar llogjika për bllokime elektrike për mosveprim në rast veprimesh të gabuara. Mbrojtjet rele dhe automatika (BCU) vendosen në panele të veçanta.
 - Për testimin dhe komisionimin e saj ndiqet një procedurë e standardizuar IEC. Kompleksiteti i punës në to kërkon gjithashtu punonjës me specializim të lartë dhe njohuri të thella për pajisjet.
 - Matja vendoset në panele të veçantë dhe ndiqet një procedurë e standardizuar testimi që është e rregulluar nga norma të rrepta IEC. Operatorët janë tepër të specializuar.
 - Në një nënstacion bëhen punime për SKADEN dhe Telekomunikacionin që kërkojnë njohje të pajisjeve dhe specializim të lartë të operatorëve dhe kompanive që punojnë.
 - Punimet për ndërtimin/rikonstruksionin/punimet e linjave të tensionit të lartë kanë vështirësi që lidhen me projektimin, ndërtimin, vendosjen e shtyllave, përcjellësve dhe elementeve të ndryshëm përbërës të saj. Ndërtimi i një linje të tensionit të lartë kërkon makina dhe pajisje speciale pa të cilat kompromentohet seriozisht cilësia e punimeve për ndërtimin e tyre. Ndërtimi i linjave të tensionit të lartë kërkon kushte teknike të veçanta dhe shumë të rrepta pasi ato ju nënshtrohen kushteve atmosferike tepër të rënda dhe duhet të paraqesin qëndrueshmëri të mjaftueshme mekanike ndaj tyre.
-

- Mund të pohojmë se, kompleksiteti, vështirësia dhe rëndësia e punimeve të sipërpërmendura rritet me rritjen e nivelit të tensionit (ndryshimi mes 110, 220 dhe 400 kV dhe niveleve të tjera më të ulëta të tensionit) dhe përcakton në mënyrë domethënëse edhe kërkesat për nivelin profesional të operatorëve që do të kryejnë ato si dhe përdorimin e makinave dhe pajisjeve.

Theksojmë se: në përcaktimin e kushteve për punime në objektet e OST sh.a., përveç rregulloreve tona, është marrë si model edhe procedura dhe kërkesat teknike të ndjekura nga Kontraktorë të huaj shumë të njohur dhe me eksperiencë që kanë punuar në objektet tona prej më shumë se 15 vite.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licence profesionale në fushën e projektimit ose të ketë marrëveshje kontraktuale notoriale me disponuesit e këtyre licencave, leshuar nga organet përkatëse, e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

<i>Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile dhe industriale</i>	<i>- Pika 4/c</i>
<i>Projektues gjeodet – bazamente gjeodezike</i>	<i>- Pika 8/d</i>
<i>Projektim impianteve ... të shpërndarjes elektrike</i>	<i>- Pika 10/c,d,e</i>

Argumentimi: Këto kategori projektimi janë në përputhje me zërat e preventivit paraprak dhe objektin e prokurimit, janë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me realizimin e punimeve, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe pika 6, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Gjithashtu, OE ofertues mund të kontraktojë disponuesit e këtyre licencave, nëse nuk janë pjesë e stafit të tij, me qëllim realizimin e kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licence profesionale, në fushën e zbatimit të punimeve, leshuar nga organet përkatëse, e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme/speciale ndërtimi:

<i>Kategoria NP-1</i>	<i>Punime germimi në tokë</i>	<i>Klasifikimi A</i>
<i>Kategoria NP-2</i>	<i>Ndërtim civil dhe industrial</i>	<i>Klasifikimi A</i>
<i>Kategoria NP-11</i>	<i>Ndërtim për N/Stacionet, kabinat dhe transformatore linjë të TN dhe të mesme dhe shpërndarjen e energjisë</i>	<i>Klasifikimi E</i>
<i>Kategoria NS -18</i>	<i>Punime topogjeodezike</i>	<i>Klasifikimi A</i>

Shënim: Në rast pjesëmarrjeje të një Operatori ekonomik të huaj, ky i fundit, Licencën e mesipërme me kategoritë e përshkruara, duhet ta ketë të njëjshuar pranë organeve përkatëse në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit të saj në fuqi.

Argumentimi: Keto kategori punimi janë në përputhje me zërat e preventivit dhe objektin e prokurimit, janë proporcionale dhe të lidhura ngusht me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe pika 6/a, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale duhet të ketë të punësuar, si drejtues teknik, të pakten 1 (një) inxhinier elektrik, 1 (një) inxhinier ndërtimi, 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet dhe 1 (një) inxhinier gjeolog.*

Punonjësit e mesiperm duhet të jenë të siguruar dhe të figurojnë në listepagesat perkatese E-Sig për 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë: kontratat individuale të punës, shoqëruar me diplomat perkatese të inxhinierëve të mesiperm, si dhe listepagesat për periudhën e kërkuar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për inxhinierët e sipërcituar është në përpjestim dhe e lidhur me objektin e kontratës, respekton edhe parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë minimale e mundur të plotësohet nga cdo OE që ka në objektin e vet tregëtar keto lloj niveli punimesh. Keto kërkesa për kualifikim janë në përputhje me pikën 6, të Nenit 39 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe Nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka fuqinë punëtore të nevojshme minimalisht 25 (njëzet e pesë) punonjës me kohë të plotë pune, për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Punonjësit duhet të jenë të siguruar të pakten për 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.*

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë listepagesat perkatese E-Sig.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me numrin e fuqisë mesatare punëtore të siguruar, duke patur parasysh volumet e punëve objekt kontrate, natyrën dhe vlerën e kontratës, ky numër punonjësish është proporcional dhe i lidhur me aftësinë zbatuese, me qëllim realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës. Numri i punonjesve është perlllogaritur duke patur në konsideratë shtrirjen gjeografike të linjes objekt punimi, si dhe volumin e punës për realizimin me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe pika 6/ç, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë minimumi 15 (pesëmbëdhjetë) punonjes, të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, nga të cilët 5 (pese) të jenë punonjes me kategorinë e sigurimit teknik IV-V, të leshuar nga shoqëri të akredituara në bazë të Ligjit Nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, i ndryshuar.*

Lidhur me këtë pikë, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë:

- i. *Listpagesat E-Sig të punonjesve të sipërcituar, si dhe*
- ii. *Kartelat përkatëse të vlefshme të sigurimit teknik.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën për personelin e pajisur me kartelat e sigurimit teknik, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë dhe të paraqesë kartelat përkatëse të punonjësve që do të kryejnë punimet objekt kontrate. Një numër i tillë të siguruarish është kërkuar pasi punimet objekt procedure prokurimi kërkojnë punonjës të kualifikuar dhe të aftë, që të punojnë sipas kërkesave të sigurisë në punë për të shmangur rrezikun për jetën, shëndetin dhe çdo problem tjetër, gjatë zbatimit të kontratës.

Punonjesit që do të realizojnë këtë kontratë, për arsye të natyrës teknike të saj dhe kushteve të punës në linjat e tensionit të lartë, duhet të respektojnë rregulloren e sigurimit teknik elektrik,

bazuar ne dispozitat ligjore perkatese per punimet mbi 1000 Volt, ne lartesi, me heqje dhe pa heqje tensioni, duke repsektuar largesine me tensionin nominal te punes per linjat 110 kV e lart.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.7 *Operatori ekonomik duhet te disponoje te pakten 2 (dy) specialistë te certifikuar per bashkim kabllorsh te tensionit te larte dhe te pakten 2 (dy) specialistë te certifikuar per te punuar me терминалет 110 kV e siper, ose te jete i mbeshtetur nga nje kompani qe i disponon keta specialistë.*

- *Kur specialistet disponohen nga operatori ekonomik te disponohet:*

I. *Listapagesat E-Sig ku te figurojne keta specialiste, dhe*

II. *Certifikatat e specialisteve.*

- *Kur specialistet disponohen nga nje kompani e trete qe mbeshtet OE ofertues, te disponohen:*

I. *Deklarata nga kompania mbeshtetese per OE ofertues qe keta specialistë i ve ne dispozicion te OE per kete projekt;*

II. *Cerfitikatat e specialisteve;*

III. *E-Sig ku te figurojne keta specialiste (Ne rast se kompania mbeshtetese eshte Shqiptare) ose Vetedeklarim qe punonjesit jane te punesuar prane kesaj kompanie (Ne rast se kompania mbeshtetese eshte e huaj).*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për specialistët e sipërcituar është në përpjestim dhe e lidhur me objektin e kontratës, respekton edhe parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë minimale e mundur të plotësohet nga cdo OE që ka në objektin e vet tregëtar keto lloj niveli punimesh. Keto kërkesa për kualifikim janë në përputhje me pikën 6, të Nenit 39 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe Nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.8 *Operatori ekonomik (ne baze te Ligjit 10237, dt. 18.02.2010, neni 5, pika 15) per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier) duhet te kete te pakten 1(nje) inxhinier te trajnuar dhe te pajisur me certificate si pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune me risk te larte, i cili te jete i siguruar te pakten per 12 (dymbedhjete) muajt e fundit dhe duhet te jete prezent ne kantier gjate ekzekutimit te punimeve. Certifikata te jete e leshuar nga shoqeri te licencuara nga ministria perkatese.*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje:

- i) certifikaten e inxhinierit;*
- ii) licencen e shoqerise e cila ka trajnuar punonjesit e operatorit ekonomik;*
- iii) listpagesat E-Sig te punonjesve te sipercituar.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Persa i perket kerkeses per nje inxhinier te trajnuar dhe te pajisur me certificate si pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune me risk te larte, argumentohet se eshte i nevojshem te qendroje ne kantierin e punimeve per te ndjekur ecurine e punes se punonjesve te OE ofertues dhe te jete i gatshem ne rastin e paraqitje se kushteve te rrezikshme qe mund te ndodhin gjate zbatimit te kontrates objekt prokurimi, ne perputhje me Ligjin Nr. 10237, date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar.

Gjithashtu, licenca e shoqërisë e cila ka trajnuar punonjësën është e nevojshme për të verifikuar nëse kjo shoqëri është e licencuar nga organet kompetente për të lëshuar kete certifikim.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.9 *Ofertuesi duhet te disponoje minimalisht mjetet e meposhtme per kryerjen e punimeve, me qellim realizimin e objektit te prokurimit:*

Nr.	Mjetet	Sasia
1	Makineri (Sonde) per shpim horizontal me sistem HDD	2 cope
2	Makineri me sistem lazer kontrolli me diameter (450-550)	2 cope
3	Eskavator me goma 0.25 m ³	1 cope
4	Kamioncine me kapacitet mbi 1.5 ton	1 cope
5	Betoniere	1 cope

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike operatori duhet te disponoje:

1. *Per mjetet, makinerite dhe pajisjet në pronësi të paraqitet akti i pronësisë (kontrata shitblerje, fatura tatimore e shitjes ose fatura e zhdoganimit).*
2. *Per mjetet, makinerite dhe pajisjet me qira të paraqitet kontratë qiraje si dhe akti i pronësisë së qiradhënësit sipas percaktimit të bere me lart.*
3. *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin (leje qarkullimi) dhe akti i kolaudimi.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Mjetet dhe pajisjet teknike të vendosura si kërkesë për tu plotësuar nga OE, janë të domosdoshme për punimet gjate realizimit të kontrates objekt procedure prokurimi, për realizimin e punimeve që do të kryhen në kantier. Kjo kërkesë është minimale dhe jodiskriminuese në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe pika 6/d, të nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që mallrat e furnizuara janë të reja (jo të rikonstruara).

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kërkuar nga AK, është vendosur në përputhje me pikën 6, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.11 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ✓ *ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë.*
- ✓ *ISO 14001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë së mjedisit.*
- ✓ *ISO 45001: për Sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë.*

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e standarteve si ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën

dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me to, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare, të objektit të kontratës.

Certifikata per sistemin e menaxhimit te cilesise ISO 9001: eshte sot referimi i njohur ne nivel nderkombetar, per certifikimin e sistemit te menaxhimit te cilesise te kompanive te te gjithë sektoreve dhe te gjithë permasave. Ky kriter kerkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Certifikata e menaxhimit të cilesisë së mjedisit ISO 14001: e kerkuar nga AK garanton se OE ofertues eshte i certifikuar per produkte te cilat nuk demtojne mjedisin dhe nuk e ndotin ate dhe qe jane konform standardeve nderkombetare te cilesise.

Certifikata për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001: eshte vendosur si kriter kualifikues per operatorët ekonomik ofertues sepse ka te beje me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila eshte me nje rendesi te vecante per kryerjen e kesaj kontrate. OE ofertues qe do te realizoje kontraten objekt procedure prokurimi duhet te kryeje punimet objekt procedure prokurimi dhe kjo kategori licence minimizon rreziquet qe mund te shfaqen gjate realizimit te kesaj kontrate.

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.12 Operatori ekonomik ofertues duhet te plotesoje saktesisht kolonen me te dhenat teknike te ofertuar ne te gjitha tabelat e paraqitura ne shtojcen 5 (Specifikimet teknike) te ketyre DT-ve.

Mosplotesimi i sakte eshte element skualifikimi.

Argumentimi: Plotësimi i këtij kriteri është vendosur në vijim të përcaktimeve të Nenit 36 te Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, me qëllim shmangien e mundësive për keq-kuptimin dhe keq-referimin nga ofertuesi të specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara. Kjo e garanton AK-në se ofertuesi e njeh konkretisht produktin e kërkuar dhe merr përsipër paraqitjen e tij pa asnjë devijim nga sa kërkohet në DT. Ky kriter është vendosur bazuar në rëndësinë e veçantë që këto pajisje kanë në procedurën objekt prokurimi, është në proporcion me vlerën dhe natyrën e kontratës.

2.3.13 Per listen e meposhtme te mallrave:

- 1. Xhunto (muftë bashkuese) 110 kV, sipas specifikimeve teknike.*
- 2. Terminale 110 kV, sipas specifikimeve teknike.*
- 3. Kabllo fuqie 110 kV, sipas specifikimeve teknike.*
- 4. Joint Box, sipas specifikimeve teknike.*

5. *Kabllo optik nëntokësor SMF, sipas specifikimeve teknike.*
6. *Transformator tensioni 110 kV, sipas specifikimeve teknike.*

Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

1. *Autorizim te prodhuesit/ve/distributorit te autorizuar per listen e mesiperme te mallrave. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*
2. *Katalog/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit, per listen e materialeve te mesiperme qe do te ofrohen, ne te cilen te paraqiten te dhenat teknike baze te perkthyer ne gjuhen shqipe.*

Shenim: *Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.*

3. *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese deshmi te testimeve zyrtare te kryera, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi te kryera me pare, qe vertetojne pajtueshmerine e materialeve te prodhuara (lista e mesiperme ose te ngjashme) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.*

Argumentimi: Në lidhje me kriterin për listën e mallrave që do të përdoren, nisur nga rëndësia e madhe e projektit dhe funksioni që ato do të kryejnë në realizimin e objektit të kontratës, si dhe nga vlera e tyre, u mendua që ky kriter të mundësojë sigurimin e mallrave cilësore me parametra që plotësohen nga prodhues të certifikuar për menaxhimin e cilësisë së mallrave. Ky kriter është në proporcion me vlerën e kontratës, është jodiskriminues dhe i mundshëm të përmbushet nga cdo operator që ka përvojë në këtë fushë objekt kontrate.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.14 Ne funksion te plotesimit te Shtojces 8 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në

cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kerkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per punimet objekt procedure prokurimi, duke perllogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar.